



Co-funded by
the European Union



Implemented by
giz
Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



UDHËZIM PËR APLIKANTË

**“RRITJA E KAPACITETEVE KONKURRUESE TË 10 KOMPANIVE MIKRO DHE TË
VOGLA NGA PRIZRENI DHE RRETHINA PËRMES DIXHITALIZIMIT TË PROCESHEVE
TË BIZNESIT”**

Data e hapjes së thirrjes:

27.12.2022 e Martë

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve:

20.01.2023 e Premte

1. Hyrje

Shoqata e Biznismenëve dhe Zejtarëve "ESNAF" me përkrahje nga komponenti Digital4Business, i cili financohet bashkërisht nga Bashkimi Evropian dhe Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik dhe zbatohet në kuadër të Qendrës së Transformimit Digjital të Agjencisë Gjermane të Zhvillimit – GIZ në Parkun për Inovacion dhe Trajnim (ITP) Prizren fton bizneset që të përfitojnë nga shërbimet për dixhitalizim.

Përmes kësaj thirrjeje shoqata ESNAF dhe GIZ synon të përkrahë ndërmarrjet mikro, të vogla drejt transformimit digjital me qëllim që të rrisin performancën, konkurrueshmërinë dhe qasjen në treg. Kjo thirrje nuk është e hapur vetëm për anëtarët e shoqatës ESNAF, por vlen për të gjitha bizneset e interesuara të cilët veprojnë në Prizren dhe rrethinë.

Projekt i cili do të zgjasë 14 muaj 10 kompani mikro dhe të vogla që operojnë në Prizren dhe rrethinë do të mbështeten në fushën e dixhitalizimit për 6 muaj, process ky që do të filloj pas vlerësimit të nevojave të bizneseve dhe zhvillimit të strategjive për ndihmë ndaj tyre. Përparësi kanë bizneset në pronësi të grave dhe komuniteteve pakicë.

Secila nga 10 kompanitë që do të kenë të drejtë të marrin mbështetje në kuadër të projektit do të ofrohen shërbime në fushën e dixhitalizimit deri në 5000 €. Kompanitë inkurajohen të bashkëfinancojnë me para të tjera vetanake mbi këtë shumë.

Mjete financiare nuk do të ofrohet asnjë kompanie brenda projektit. Mbështetja që do të takojë do të ofrohet nga shërbimi që do të ofrohet në fushën e dixhitalizimit.

2. Kush mund të aplikoj?

- ✓ Të gjitha kompanitë me madhësi mikro dhe të vogël sipas kategorizimit të ATK-së dhe sipas Ligjit të Kosovës nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja si në vijim (mikro prej 0 deri në 9 punëtorë, e vogël prej 10 deri në 49 punëtorë) nga rrethi i Prizrenit
- ✓ E hapur për kompani nga të gjithë sektorët përveç TIK-ut
- ✓ Gatishmëri për të dixhitalizuar aktivitetet e tyre të biznesit
- ✓ Angazhimi ndaj projektit në formën e kohës së stafit, etj

3. Cila bizneset kanë përparësi?

- ✓ Kompanitë e lidhura me sektorët sipas rezultateve paraprake të "Procesit të Specializimit të zgjuar për Kosovën" (Përpunimi i Ushqimit dhe Drurit, Energjisë së Gjelbër, Industrive Kreative)

Kompanitë nga çdo sektor i aktiviteteve të NVM-ve në përputhje me [Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane](#)

- ✓ Kompanitë në pronësi të femrave
- ✓ Kompanitë në pronësi të minoriteteve
- ✓ Kompanitë me më shumë punonjësesh gra dhe komuniteteve pakicë
- ✓ Kompanitë që do të ofrojnë vende të reja pune
- ✓ Kompanitë e hapur për bashkëfinancim
- ✓ Kompanitë me potencial rritjeje përmes dixhitalizimit

4. Mënyra e aplikimit

- ✓ Aplikimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët dhe deklaratën nën betim të ndërmarrjes janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare www.esnaf-rks.org.
- ✓ Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen në format PDF me email: project@esnaf-rks.org ose origjinalet mund të i sjellni me zarf të mbyllur në adresën e mëposhtme:

*Shoqata e Biznismenëve dhe Zejtarëve ESNAF
Rr. Ismet Jashari Kumanova, pn. 20000 Prizren*

Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet emri i thirrjes publike, së bashku me emrin e plotë dhe adresën e aplikuesit.

- ✓ Të gjitha dokumentet duhet të plotësohen në forme digjitale.
- ✓ Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është deri me datën 20.01.2023 e Premte në orën 16:00.

5. Dokumentet e kërkuara

Aplikimi i bizneseve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

- ✓ Formulari i Aplikimit
- ✓ Kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar të biznesit
- ✓ Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha fletët/informatat percjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, certifikata duhet të jetë e rielshuar nga ARBK sipas numrit unik identifikues
- ✓ Vërtetimi tatimor me validitet në ditën e aplikimit; me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore, ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK (mund të nxjerret online nga uebfagia e ATK-së)

- ✓ Lista e punëtorëve për vitin e fundit fiskal (2022), të lëshuar nga ATK (mund të nxjerret online nga uebfagja e ATK-së)
- ✓ Qarkullimi vjetor për vitin 2021 duhet të jetë i dëshmuar nga ATK
- ✓ Certifikatë nga Gjykata Themelore për personin e autorizuar të biznesit që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe nuk është dënuar nga gjykata

Vërejte: Me aplikimin në këtë program, kompanitë pajtohen që të dhënat e tyre të ndahen me GIZ-in dhe komponentin që e përkrahë këtë program.

